

## DHUNA NË ÇIFT

### ËSHTË E

## PATOLERUESHME!

### KUSH MBROHET NGA LIGJI?

Ligji mbron çdo person viktimë të dhunës në çift, cilado qoftë lidhja që i bashkon autorin/autoren dhe viktimën (bashkëshortë, partnerë të rregjistruar, bashkëjetues, etj).

### ÇFARË NDIHME MUND TË MARRË VIKTIMA?

Nëse viktimë ka pranuar që të transmetojë të dhënat e saj, ajo do të kontaktohet nga Qendra LAVI (shiko kartën e urgjencës). Viktimë mund të kontaktojë Qendrën LAVI edhe me iniciativën e saj. Asaj do t'i propozohet një konsultim falas.

Nëse viktimë dëshiron të qëndrojë në banesë pas dëbimit të autorit/autore, policia do t'i propozojë të telefonojë EMUS (shiko kartën e urgjencës) që të mund të përfitojë një asistencë në rast urgjence.

Viktimë mund të marrë gjithashtu kontakt me Qendrën e pritjes «MalleyPrairie» ose të shkojë atje spontanisht, si ditën edhe natën (shiko kartën e urgjencës). Qendra « MalleyPrairie » propozon gjithashtu konsultime në të gjitha rrethinat e komunës, duke përfshirë edhe në banesë, si pasojë e dëbimit të autorit/autore.

### ÇFARË NDIHME MUND TË MARRË AUTORI/AUTORJA E DHUNËS?

Në rast dëbimi nga policia, CPAle (shiko kartën e urgjencës) merr kontakt me personin e dëbuar me qëllim që të mund të caktojë të paktën një bashkëbisedim falas social-edukativ të detyrueshëm, i cili do t'i lejojë atyre të vlerësojnë situatën dhe pasojat e dhunës për të gjithë personat e implikuar.

Personi i dëbuar mundet gjithashtu të marrë ndihmën e EMUS, sidomos për të gjetur një strehim urgjent.

Autori/autorja e dhunës mundet të kontaktojë gjithashtu CPAle me iniciativën e tij/saj me qëllim që të përfitojë një bashkëbisedim

falas për këshillim dhe orientim. CPAle propozon disa programe që ndihmojnë në menaxhimin e emocioneve me qëllim që të zvogëlojnë dhunën.

### KUSH MUND TË DËBOHET?

Policia mund të dëbojë menjëherë nga banesa e tij/saj autorin/ autoren e dhunës në çift.

### KUSH VENDOS PËR DËBIMIN?

Policia dëbon autorin/autoren që të evitojë dhunë tjetër të re. Viktimë nuk mund t'a kundërshojë këtë masë. Kjo masë paraqitet sistematikisht në gjykatë e cila jep një urdhër dhe cakton një seancë gjyqësore brenda katërbëdhjetë ditëve.

### FAKTI QË JENI PRONAR OSE QIRAXHI I BANESËS, A E INFLUENCON DËBIMIN?

Jo, kjo nuk luan asnjë rol. Policia mund të dëbojë çdo person që është autor i dhunës, qoftë pronari i banesës ose i vetmi person që ka firmosur kontratën e qeramarrjes.

### ÇFARË MUND TË MARRË ME VETE PERSONI I DËBUAR?

Ai mund të marrë sendet e tij personale të nevojshme (p.sh. dokumentet e tij personale, rrobat e tij, ilaçet e tij, laptopin e tij personal, etj).

### SA ËSHTË KOHËZGJATJA E DËBIMIT?

Dëbimi është i vlefshëm për tridhjetë ditë maksimumi. Sipas kërkesës, gjykata mund të marrë masa të tjera mbrojtjeje ose largimi, si edhe të urdhërojë një dëbim për një kohëzgjatje të re.

### A MUND TË KTHEHET PERSONI I DËBUAR PASI TË JETË QETËSUAR?

Jo para afatit të caktuar. Dëbimi u lejon të dy palëve të mendohen mbi situatën dhe të marrin, në rast nevojë, masat e duhura.

### ÇFARË MUND TË BËJMË NËSE PERSONI I DËBUAR NUK I RESPEKTON NDALIMET?

Viktimë nuk duhet t'ia hapë derën personit të dëbuar. Ajo duhet t'i telefonojë menjëherë policisë dhe t'i tregojë që dëbimi nga banesa është efektiv. Nëse është nevojë, viktimë mund t'i paraqesë policisë urdhrin e dëbimit të dhënë nga gjykata.

## KARTA

## E URJENCËS

### URJENCA

**Policia** | PËR ÇDO SITUATË URJENTE 24/24 ORË  
117 ose 112

**Urgjencia mjekësore** | 24/24 ORË  
144

**Équipe mobile d'urgences sociales (EMUS)**  
(Ekipi Mobil i Urgjencës Sociale) | 24/24 ORË  
0848 133 133

### NDIHMA NDAJ VIKTIMAVE

**Centre MalleyPrairie**  
(Qendra e pritjes e «MalleyPrairie») | DËGJIM DHE STREHIM 24/24 ORË  
Chemin de la Prairie 34 - 1007 Lausanne  
021 620 76 76 - info@malleyprairie.ch

**Centre LAVI** (Qendra LAVI) | NDIHMA NDAJ VIKTIMAVE  
Rue du Grand-Pont 2 bis - 1003 Lausanne - 021 631 03 00  
- Rue de la Plaine 2 - 1400 Yverdon-les-Bains - 021 631 03 08  
- Rue du Molage 36 - 1860 Aigle - 021 631 03 04

### KËSHILLA PËR AUTORIN/AUTOREN/AUTORËT E DHUNËS

**Centre de Prévention de l'Ale (CPAle)**  
(Qendra e Parandalimit të Ale)  
Rue de l'Ale 30 - 1003 Lausanne  
021 321 24 00 - info@prevention-ale.ch

### LEJE QËNDRIMI

**La Fraternité du CSP**  
(Vëllazëria e CSP) | PYETJE MBI LEJEN E QËNDRIMIT  
Place M.-L. Arlaud 2 - 1003 Lausanne  
021 213 03 53 - frat@csp-vd.ch

## LEJE QËNDRIMI

### Service de la population

(Shërbimi i popullsisë) | AUTORITETI PËRKATËS PËR LEJET E QËNDRIMIT  
Av. de Beaulieu 19 - 1014 Lausanne

### KONSTATIMI MJEKËSOR

#### Unité de médecine des violences

(Njësia e mjekësisë për dhunat)  
CHUV - Rue du Bugnon 44 - 1011 Lausanne - 021 314 00 60

#### Hôpital d'Yverdon-les-Bains

Rue d'Entremonts 11 - 1400 Yverdon-les-Bains - 024 424 42 20

#### Hôpital Riviera Chablais - Site de Montreux

Av. de Belmont 25 - 1820 Montreux - 021 966 64 77

#### Nyon

Avenue Reverdil 8 - 1260 Nyon - 021 314 08 51

### GJYKATAT E KRAHINËS

#### Tribunal d'arrondissement de Lausanne

Palais de justice de Montbenon  
Allée E.-Ansermet 2 - 1014 Lausanne

#### Tribunal d'arrondissement de la Broye et du Nord vaudois

Rue des Moulins 8 - Case postale - 1401 Yverdon-les-Bains

#### Tribunal d'arrondissement de l'Est vaudois

Cour-au-Chantre - Rue du Simplon 22 - 1800 Vevey

#### Tribunal d'arrondissement de La Côte

Rue de Saint-Cergue 38 - 1260 Nyon

[www.violencequefaire.ch](http://www.violencequefaire.ch) (dhunë, ç'mund të bëj)

NJË SAJT INTERNETI KU JU MUND TË BËNI PYETJET TUAJA NË MËNYRË ANONIME

**Bureau de l'égalité** (Zyra e barazisë)

021 316 61 24 - [info.befh@vd.ch](mailto:info.befh@vd.ch)  
[www.vd.ch/violence-domestique](http://www.vd.ch/violence-domestique)

## KUJDESUNI PËR

## SIGURINË TUAJ.

Mundësia për të dëbuar autorin/autoren i lejon viktimës të qendrojë në banesë. Megjithatë, kjo nuk ofron mbrojtjen absolute kundër dhunave të reja.

Është e vështirë të çlirohesh nga një lidhje ku ka keqtrajtim, dhe për këtë nevojitet kohë. Në një periudhë të tillë, është thelbësore të kërkohet çdo lloj ndihme e disponueshme.

NË SITUATË RREZIKU:

**THIRRJE URGJENTE NË POLICI**

**117 ose 112**

...

Policia do të kujdeset të largojë personin e dëbuar, dhe nëse është nevoja, edhe duke e detyruar atë. Në disa raste, mospranimi i ndalimit/dëbimit, mund të sjellë edhe sanksione penale.

Nëse personi i dëbuar thotë se ka nevojë për sendet e tij (veshje, dokumente, etj), ai duhet të marrë kontakt me policinë, e cila do t'a shoqërojë në banesën e tij.

Në rast ngacmimi ose shqetësimi me anë të telekomunikimit, viktima nuk duhet të përgjigjet. Ajo mund t'i kërkojë gjykatës t'i ndalojë autorit/autores të marrë kontakt me atë dhe të bëjë një denoncim penal për përdorim abuziv të një instalacioni të telekomunikimit.

### NJË PERSON I HUAJ, A E HUMBET AI/AJO LEJEN E QËNDRIMIT NËSE POLICIA DËBON PARTNERIN/PARTNEREN E TIJ/SAJ?

Jo. Dëbimi është vetëm një mënyrë me kohëzgjatje të shkurtër për të larguar rrezikun. Nëse leja e qëndrimit të viktimës është e lidhur me atë të personit të dëbuar, rekomandohet të merrni të dhëna pranë Vëllazërisë të CSP (Fraternité du CSP) (shiko kartën e urgjencës) në rast ndarje me kohë të gjatë.

**KUSH  
GODET,  
LARGOHET!**

Informacione dhe këshilla për viktimat dhe autorët  
/ autorët e dhunës në çift

